

VENDIM
Nr.237, datë 23.4.2004

**PËR SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2004-2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 56 dhe 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin e arsimit parauniversitar" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien falas, për çdo vit shkollor, të teksteve të klasës së parë të arsimit të detyruar, duke filluar nga viti shkollor 2004-2005.

2. Dhënien falas të të gjitha teksteve të arsimit të mesëm të përgjithshëm, për vitin shkollor 2004-2005, për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të arsimit të përgjithshëm të komunave më të varfëra, sipas vendimit nr.718, datë 30.10.2003 të Këshillit të Ministrave "Për mbështetje të diferencuar financiare për disa komuna".

3. Botimi, shtypja dhe shpërndarja e teksteve shkollore dhe e fletoreve të punës, për vitin 2004, të mbulohen nga subvencioni i parashikuar në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

4. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano